



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:092684

Datë: 26.12.2023

Numri i dokumentit: 05118852

Ep.nr.111/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Blerta Kelmendi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit K “A.....”, SH.A, me adresë rruga ”Xh. S”, Fusha e Pejës, rruga e Transimit, p.n, Pejë, ndaj debitorit G. Sh, nga Peja, i përfaqësuar me autorizim nga av.Filloreta Hoxha-Zymberi, rruga “Sh. B”, në Pejë, me bazë juridike përmbartimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat Jeton Krasniqi, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.28/22, i datës 28.03.2022, jashtë seancës gjyqësore, me datë 26.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESËRISHT SI I BAZUAR, prapësimi i debitorit G. Sh, me adresë në rrugën “Nëna Terezë”, p.n, në Pejë, ashtu që SHFUQIZOHET pjesërisht Urdhri i Përmbartuesit Privat Jeton Krasniqi, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.28/22, i datës 28.03.2022, sa i përket shumës së borxhit në lartësi prej 611.55 euro.

II.REFUZOHET I PABAZUAR, pjesa tjetër e prapësimit të debitorit dhe MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor i Përmbartuesit Privat Jeton Krasniqi, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.28/22, i datës 28.03.2022, sa i përket shumës prej 70.00 euro.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Kreditori KRM “AMBIENTI”, SH.A., me seli në Pejë, me datë 25.03.2022, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve të bartjes së mbeturinave, për periudhën kohore nga data 01.03.2003 e deri më 28.02.2022, në shumën prej 681.55 euro.

Përmbartuesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Urdhrin Përmbartimor P.nr./I.Br.28/22, i datës 28.03.2022, duke lejuar përmbartimin e propozuar.

Debitori në afatin e lejuar ligjor, me datën 21.04.2022, ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbartimor, nën arsyetimin se sipas dispozitave të nenit 360 par.1 nënpar.1.1 të LMD-së, konsiston në atë se: “kërkesat të cilat parashkruhen pas një viti janë kërkesat për furnizim me energjisë elektrike, energji termike, gazit, ujit dhe shërbimeve për pastrimin e oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi është kryer për nevojat shtëpiake”, andaj në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afariste me nr:2478, shumica dërrmuese e kërkesave janë të parashkruara. Gjithashtu me parashkrimin e kërkesës kryesore janë parashkruar edhe ato aksesore siç është kamatëvonesa. Dispozitivi i urdhrin përmbartimor është i mangët në kundërshtim me ligjin dhe i paekzekutueshëm. Në rastin konkret nuk dihet kush është kreditor dhe debitor, poashtu përmbartimi është lejuar nga përmbartuesi vetëm duke e vendosur vulën, mirëpo ky urdhër nuk përmban asnjë nga elementet e përcaktuara në nenin 43 par.1 të LPP-së, nuk është saktësuar nëse kredia është bërë e kërkueshme, si dhe i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin, ta anuloj urdhrin përmbartimor, dhe të obligohet kreditorit që debitorit të ia paguaj shpenzimet e procedurale sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, në afat prej 15 ditësh pas vendimit të formës së prerë.

Kreditori lidhur me pretendimet në prapësim nuk ka dhënë përgjigje në prapësim.

Gjykata në procedurën përmbartimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e palës debitore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka gjetur se prapësimi është pjesërisht i bazuar.

Shqyrtimi i ligjshmërisë së urdhrin përmbartimor dhe dokumentit të besueshëm.

Në propozimin për përmbartim të kreditorit të datës 24.03.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Jeton Krasniqi, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.28/22, i datës 28.03.2022, në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstrakti nga librat afariste, nga ana e kreditorit është kërkuar borxhi për periudhën

kohore nga data 01.03.2003 e deri më 28.02.2022, në shumën prej 681.55 euro, në emër të bartjes së mbeturinave.

Gjykata vlerëson se dokumenti i besueshëm-ekstrakti nga librat afariste, mbi bazën e së cilës është filluar procedura përmbarimore, është dokumenti juridik i besueshëm dhe titull i përshtatshëm për përmbarim, dhe si i tillë plotëson të gjitha kushtet ligjore në kuptim të dispozitës së nenit 29 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP-së), që përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*. Në këtë drejtim, dokumenti i besueshëm, mbi bazën e së cilës është aprovuar edhe urdhri për përmbarim është i ligjshëm dhe në harmoni me par.3 të nenit 29 të LPP-së, që përcakton se: *“Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata pas konstatimit të ligjshmërisë të urdhrin përmbarimor, gjen se prapësimi i debitorit se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së kreditorit për arkëtimin e borxhit në rrugë gjyqësore, është pjesërisht i bazuar, konform nenit 378 par.1 të LMD-së së ish-RSFJ-së dhe nenit 360 par.1 të LMD-së.

Gjykata parashkrimin e borxhit për periudhën nga 01.03.2003 e deri më 18.12.2012, ka zbatuar dispozitat e LMD-së të ish RSFJ-së (i vitit 1978), si ligj në fuqi në kohën kur është krijuar marrëdhënia juridike civile, kurse nga 19.12.2012 e tutje, gjykata ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr.04/L-077- të Marrëdhënieve të Detyrimeve LMD-së (të vitit 2012).

Gjykata konstaton se kreditori për një pjesë të kërkesës ka humbur afatin ligjor brenda të cilit do të mund të arkëtonte forcërisht borxhin përmes rrugës gjyqësore, saktësisht për borxhin që përfshin periudhën kohore nga data 01.03.2003 e deri më 31.12.2020, në shumën prej 611.55 euro për shkak të parashkrimit.

Kreditore propozimin për përmbarim, e ka paraqitur më datën 24.03.2022 dhe sipas vlerësimit të gjykatës, borxhi i krijuar nga ana e debitorit që nga data 01.03.2003 e deri më 31.12.2020 është

parashkruar, sepse ka kaluar afati 1 vjeçar brenda së cilës kreditori ka pasur mundësi të kërkoj përmbushjen gjyqësore të detyrimit, referuar nenit 378 të LMD-së të ish-RSFJ-së: *“Parashkruhen për një vjet: kërkesa e kompensimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”* dhe nenit 360 par.1 pika 1.1 dhe par.2 të LMD-së që përcakton se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake; 2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. Kurse neni 341 par.1 i LMD-së përcakton se: “Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit.”*

Gjykata fillimisht vlen të sqaron se afatin e parashkrimit e ka llogaritur për dy periudha kohore, respektivisht, për periudhën kohore e cila është e përcaktuar në Kontratën nr.555 që kreditori dhe debitori e kanë lidhur për pagesën e borxhit me këste me datën 06.06.2018 dhe për periudhën kohore që nuk përfshihet në kontratën e lartë cekur.

Gjykata thekson se kreditori dhe debitori me datën 06.06.2018, kanë lidhur Kontratën nr.555 për pagesën e borxhit me këste, për borxhin e periudhës kohore nga data 01.03.2003 e deri 31.05.2018, në shumë prej 464.95 euro. Duke qenë se palët kanë pasur të lidhur kontratën për periudhën e lartë cekur, gjykata afatin e parashkrimit për borxhin e periudhës së cekur në kontratë, e që përfshihet edhe në propozimin për përmbarim, e ka llogaritur nga data e lidhjes së kontratës, me 06.06.2018. Referuar paragrafit 2 të nenit 360 të LMD-së, afati i parashkrimit fillon të rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. Në këtë rast, gjykata vlerëson se afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë në fund të vitit kur është lidhur kontrata, respektivisht me datë 31.12.2018, ndërsa borxhi i përcaktuar me këtë kontratë (nga data 01.03.2003 e deri 31.05.2018) është parashkruar pas një viti respektivisht me 31.12.2019. Parashkrimi për këtë periudhë ka ndodhur për shkak se kreditori propozimin për përmbarim e ka paraqitur 24.03.2022, e që konform nenit 360 par.1 të LMD-së është paraqitur jashtë afatit ligjor.

Gjykata vlen të theksoi se edhe çdo borxh i krijuar nga data 01.06.2018 deri më 31.12.2020, periudhë kjo që nuk përfshihet në Kontratën nr.555, ka arritur parashkrimin. Kjo për shkak se për borxhin e datës 01.06.2018, ka filluar të rrjedh parashkrimi në fund të vitit 2018, saktësisht me 31.12.2018, ndërsa është parashkruar pas një viti respektivisht me 31.12.2019. Me të njëjtin

arsyetim ka rrjedh parashkrimi dhe është parashkruar edhe borxhi i vitit 2019, i cili është parashkruar me 31.12.2020, borxhi i vitit 2020, është parashkruar me 31.12.2021, kjo në mbështetje të nenit 360 par.1 të LMD-së, për shkak të paraqitjes së propozimit për përmbarrim nga kreditori jashtë afatit ligjor 1 vjeçar.

Në këtë drejtim, paraqitja e propozimit për përmbarrim nga kreditori me 24.03.2022, jashtë afatit ligjor 1 vjeçar ka rezultuar me parashkrimin e borxhit për periudhën nga data 01.03.2003 e deri me 31.12.2020 (*që përfshin periudhën kohore të përcaktuar në kontratë dhe periudhën jashtë kontratës*) në shumën prej 611.55 euro.

Vendosja si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit.

Gjykata konstaton se debitori detyrohet ti paguaj kreditorit shumën prej 70.00 euro për shërbimet e bartjes së mbeturinave, për periudhën kohore nga 01.01.2021 e deri më 28.02.2022, për shkak se borxhi i akumuluar gjatë kësaj periudhe nuk është parashkruar.

Kreditore me paraqitjen e propozimit për përmbarrim të datës 24.03.2022 e ka ndërprerë parashkrimin e borxhit për periudhën nga data 01.01.2021 e deri më 28.02.2022. Kjo për shkak se parashkrimi i borxhit i vitit 2021 ka filluar të rrjedhë në fund të këtij viti, pra me 31.12.2021 dhe borxhi i vitit 2021 do të parashkruhej pas një viti, respektivisht me 31.12.2022, ndërsa borxhi i vitit 2022, do të parashkruhej me 31.12.2023, kurse kreditore propozimin për përmbarrim e ka paraqitur me datën 24.03.2022, brenda afatit ligjor 1 vjeçar, të paraparë me nenin 360 par.1 të LMD-së. Paraqitja e propozimit ka ndërprerë parashkrimin e borxhit në kuptim të nenit 369 par.1 të LMD-së, që përcakton se: *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*.

Për këtë pjesë të detyrimit, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit, dhe debitori detyrohet që shumën prej 70.00 euro t’ia paguaj kreditorit.

Pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim se në propozimin për përmbarrim nuk është cek fare se cili është kreditore dhe cili është debitori me çka pretendohet që edhe nxjerrja e urdhrat përmbarrimor vetëm me vulosjen e tij është në kundërshtim me ligjin dhe i paekzekutueshëm, gjykata i vlerëson si të pabazuara për faktin që nga vlerësimi i propozimit për përmbarrim konstatohen palët kreditore dhe debitorë, shuma e detyrimit, periudha për të cilën kërkohet, dhe

mbi bazën e kësaj është nxjerr urdhri përbarimor përmes vulosjes së propozimit e që është në përputhje me nenin 44 par.1 të LPP-së sipas të cilit: *”Aktvendimi për përbarimin apo urdhri për përbarim nuk duhet ta ketë domosdo pjesën arsyetuese. Ky aktvendim apo urdhër mund të nxjerrët edhe duke u vënë vula katrore në propozimin për përbarim”*. Sa i përket pretendimit lidhur me mos provueshmërinë e arritjes së kërkueshmerisë së kredisë së kreditorit, gjykata e vlerëson si të pabazuar për faktin se një deklaratë e tillë merret nëse nga dokumenti i besueshëm nuk shihet nëse është bërë e kërkueshme kredia, ndryshe nga rasti konkret, që përmes ekstraktit afarist nr:118, të lëshuar nga kreditori i cili përmban kohën e detyrimit, shumën e detyrimit, periudhën e faturimit dhe pagesat eventuale.

Pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, gjykata i vlerëson si jo relevante për vendosje ndryshe në këtë çështje përbarimore, për më tepër gjykata thekson se procedura përbarimore zbatohet përmes aplikueshmerisë së parimit të rigoroz dhe formal, përmes së cilës bëhet vetëm vlerësimi i ligjshmërinë formale të urdhrit përbarimor dhe dokumentit të besueshëm dhe në këtë drejtim, gjykata nuk mund të lëshohet në shqyrtimin material të përmbajtjes së tij dhe fakteve eventuale kontestuese.

Gjykata vëren se debitori në vitin 2018 kishte bërë disa pagesa, mirëpo këto pagesa, nuk e ndërpresin parashkrimin për pjesën e borxhit që tashmë ishte parashkruar. Pagesa e këstit e ndërpret parashkrimin për të gjitha kërkesat për të cilat nuk ka skaduar afati 1 vjeçar por jo edhe për kërkesat për të cilat nga momenti i pagesës kanë kaluar mbi 1 vit, sepse këto kërkesa nuk përfaqësojnë borxh unik por janë kërkesa të specifikuar mujore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, që secila palë të bartë shpenzimet e veta procedurale duke i refuzuar shpenzimet procedurale të kërkuara nga debitori për faktin se debitori vetëm pjesërisht ka pasur sukses me pretendimet e tij të paraqitura në prapësim si dhe shpenzimet nuk i ka specifikuar sipas detyrimit që i përcakton ligji, andaj ka vendosur në harmoni me nenin 452 par.2 të LPK-së e cila përcakton se: *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*, si dhe nenit 463 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”*.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i datës 18 dhjetor 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse e çështjes, gjykata u bazua në nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përgjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit”*.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 29 par. 1 nënpar.2, nënpar.3 dhe par.3 lidhur me nenin 73 dhe nenit 77 par.1 dhe 5 të LPP-së dhe neni 360 par.1 dhe 2, lidhur me nenin 369 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL

2022:092684
Ep.nr.111/2022, me datë 26.12.2023.

G j y q t a r j a

Blerta KELMENDI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh
nga dita e pranimi të aktvendimit, përmes
Gjykatës Themelore në Pejë.